



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**Lënda: Kthim përgjigje**

**Drejtuar:** \_\_\_\_\_

**e.mail:** \_\_\_\_\_

Në përgjigje të kërkesës tuaj, regjistruar në Bashkinë Shkodër me nr.10235 prot , datë 16.06.2019, në të cilën në bazë të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit" kërkoni informacion për investimet në sistemin arsimor parauniversitar 2017-2018, ju bëjmë me dije se: informacionin e kërkuar dhe jo vetëm, mund ta gjeni në faqen e internetit [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), duke klikuar në linkun buxheti (buxheti 2017-2018), në zërin P9Arsimi. Buxheti i vitit 2017 dhe afatmesëm i vitit 2018-2019.

Faleminderit për bashkëpunimin.

**KRYETAR**

**Voltana ADEMI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KRYETARI**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2019

**INFORMACION**

**SHKOLLA 9- VJEÇARE “MARTIN CAMAJ” ,SHKODËR**

**DREJTORIA RAJONALE ARSIMORE, SHKODËR**

**Të nderuar,**

Në vijim të shkresës, ardhur nga shkolla 9- vjeçare “Martin Camaj” me nr 190 prot datë 15.01.2019, shkresës të ardhur nga DAR me nr 120/1 datë 15.01.2019, në lidhje me shqetësimin e ngritur për një subjekt tregtar që ushtron aktivitetin në oborrin e shkollës. Bashkia Shkodër sqaron si më poshtë:

Bashkia Shkodër me datën 17.1.2019 ka ngritur grupin e punës për të bërë verifikimin e problematikës. Grupi i punës ka ushtruar funksionin e vet duke bërë të mundur mbylljen e aktivitetit tregtar.

Me fillimin e punimeve për mirëmbajtjen e shkollave do të mbyllet dhe hapsira që ka ushtruar aktivitetin subjekti privat.

Faleminderit për bashkëpunimin.

**KRYETAR**

**Voltana ADEMI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KRYETARI**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2019

**NJOFTIM**

**DREJTORIA RAJONALE ARSIMORE, SHKODËR**

Në zbatim të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Udhëzimit Nr. 30 Datë 27.12.2011 “Per Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik, Vendimit Nr. 319, datë 12.4.2017 ”Për miratimin e standardeve të projektimit të shkollave” neni 28, të ligjit nr 69/2012 “Per sistemin arsimor parauniversitar ne Republikene e Shqiperise”, të ndryshuar, informojmë si më poshtë:

Siç jeni në dijeni, Bashkia Shkodër ka fituar në projektin “Jeto me Sportin”, projekt që përfshin **“Rikualifikim i terreneve sportive në shkollat: ” Oso Kuka”, “Oblikë” Njësia Adminsitrativë Ana e Malit, “At Gjon Karma”, Njësia Administrative Gur i Zi”.**

Me lidhjen kontaktës ka filluar dhe zbatimi i projektit në këto shkolla. Gjatë vizitës së radhës për vënien në dispozicion të sheshit të ndërtimit, nga Bashkia Shkodër për fillimin e punimeve në këto objekte, kemi hasur pengesa për lirimin e sheshit të ndërtimit në shkollën “Oso Kuka”.

Drejtoresha e shkollës “Oso Kuka” zj. Teuta ÇOKU ka disa pretendime në lidhje me zbatimin të projektit. Drejtorja e shkollës kërkon që fushat sportive të jenë të mbuluara dhe mos të zbatohet projekti i miratuar nga ana e Bashkisë, deri në plotësimin e kërkesës për realizimin fusha sportive të mbuluara.

Si rezultat i mos lejimit të zbatimit të projektit, drejtorja e shkollës do të mbajë përgjegjësi ligjore, meqense Bashkia Shkodër ka detyrime kontraktuale për realizimin e projektit.

Të merren masa për krijimin e bashkëpunimit për zbatimin e projektit.

Faleminderit për mirëkuptimin.

**KRYETAR**

**Voltana ADEMI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KRYETARI**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2019

**PËRGJIGJE TUAJËS ME NR 103 DATË 30.01.2019**

**SHKOLLA E MESME “OSO KUKA”  
ZJ TEUTA ÇOKU, DREJTORE**

Në zbatim të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Udhëzimit Nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik, Vendimit Nr. 319, datë 12.4.2017 ”Për miratimin e standardeve të projektimit të shkollave” neni 28, te ligjit nr 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, informojmë si më poshtë:

Siç jeni në dijeni, Bashkia Shkodër ka fituar projektin “**Jeto me Sportin**”, projekt në standart që përfshin “Rikualifikim i terreneve sportive” në disa shkolla përfshi dhe shkollën ” Oso Kuka”.

Ky projekt i miratuar nga **Ministria e Arsimit dhe Sportit**, do realizohet me bashkëfinancimin e Qeverisë dhe të Bashkisë Shkodër.

Në lidhje me pretendimet e parashtruara nga ana drejtorisë së shkollës për zbatimin e projektit, ku kërkohet që njëra nga fushat sportive të jetë e mbuluar dhe të ndërtohen dhomat e zhveshjes, Bashkia Shkodër po zbaton një projekt që është konform standardeve teknike të kërkuara dhe të miratuara nga ministria.

Meqenëse, jeni një nga shkollat e përzgjedhura për implementimin e këtij projekti, kërkojmë bashkëpunimin nga ana juaj.

Faleminderit për mirëkuptimin.

**KRYETAR**

**Voltana ADEMI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**  
**KRYETARI**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**SHPREHJE FALENDERIMI**

**EMISIONIT STOP-TV KLAN**

Bashkia Shkoder, duke marre shkas nga informacioni i dhënë në emisionin tuaj Stop ne Tv Klan, beri te mundur sensibilizimi dhe zgjidhjen përfundimtare te problematikes të ngritur nga

nje grup qytetaresh, që ne amientet e oborrit të shkollës “Prenk Jakova”, ushtrohet aktivitet privat-fastfood.

Faleminderit për bashkëpunimin.

**KRYETAR**

**Voltana ADEMI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KRYETARI**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2019

**ANKESË**

**DREJTORIA RAJONALE ARSIMORE, LEZHË  
Adresa: Sheshi Gjergj Kastrioti , Lezhë**

**ZYERA ARSIMORE, SHKODËR**  
**Adresa: pranë Shkollës “Martin Camaj”**

Në zbatim të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Udhëzimit Nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik, nga informacioni i dhënë në media, informohemi që pranë shkollës “Prenk Jakova”, në oborrin e saj ushtrohet aktivitet privat.

Sa më sipër, nga drejtoria e shkollës nuk kemi patur informacion zyrtar për këtë problematikë, e cila lë hapsirë për të menduar dhe dyshuar, që drejtoria e shkollës, mund të ketë dakordësuar me subjektin privat për ta lejuar të ushtrojë aktivitetin e saj. Në këto kushte, jemi para faktit të shkeljes dhe cenimit të mbarëvajtjes të procesit mësimor, shëndetit të nxënësve dhe imazhit të një instituconi publik arsimor.

Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë shqetësim dhe të procedohet sipas ligjit.

Faleminderit për bashkëpunimin.

**KRYETAR**

**Voltana ADEMI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**  
**KRYETARI**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019



## **NJOFTIM**

### **SHKOLLËS SË MESME “SHEJNAZE JUKA” DREJTORISË SHKODËR**

**DREJTORISË RAJONALE ARSIMORE, LEZHË**  
**Adresa: Sheshi Gjergj Kastrioti , Lezhë**

#### ***Të nderuar,***

Në zbatim të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Udhëzimit Nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik, te ligjit nr 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, në bazë të shkresës të Bashkisë Shkodër me nr 3352 datë 28.02.2019, shkresës me nr 5801 datë 09.04.2019”propozim për miratimin e KZAZ-ve njoftojmë si më poshtë:

- Nisur nga ngjarja e ndodhur me datë 18.06.2019, tek shkolla “Shejnaze Juka”, ku një grup personash kanë dëmtuar materiale (kartoni) të depozituara nga KQZ,
- Nisuar nga fakti, se Bashkia Shkodër dhe KQZ në faqen e saj zyrtare, nuk kanë propozuar, miratuar apo publikuar informacionin, që kjo shkollë do të jetë në funksion si KZAZ,
- Në kushtet e uzurpimit të një pjese të ambjentëve të shkollës ku, si pasojë ndodhi dhe dëmtimi i materialeve dhe ndotja nga zjarri,

#### **KËRKOJMË:**

Që në vazhdim, në asnjë moment të mos lejohet depozitimi i materialeve që nuk i përkasin shkollës dhe që nuk kanë autorizim nga institucioni i Bashkisë Shkodër, i cili e ka në pronësi dhe administrim objektin.

Sa më sipër, të ndodhur në këtë situatë, për personat përgjegjës që kanë lejuar dhe do të lejojnë depozitimin e këtyre materialeve pa autorizim, do të veprojmë sipas ligjit.

Bashkëngjitur dokumentacioni zyrtar.

Faleminderit për bashkëpunimin.

**KRYETAR**

**Voltana ADEMI**